

TEGOLA EDILCENTRO SH.P.K.

PASQYRAT FINANCIARE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

Përmbajtja

Pasqyra e Pozicionit Financiar _____	1
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto _____	4
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare _____	5
Shënimet Shpjeguese _____	6

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
AKTIVET			
I. Aktivet Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	8,605,350	9,057,596
Të drejta të arkëtueshme	5	130,667,797	120,707,083
Të tjera të drejta të arkëtueshme	6	10,865,931	9,054,471
Inventarët	7	218,955,306	220,341,071
Totali I aktiveve afatshkurtra		369,094,384	359,160,221
II. Aktivet afatgjata			
Aktive materiale	8	1,144,994,520	1,151,691,326
Aktive jo-materiale	9	1,300,000	1,300,000
Totali I aktiveve afatgjata		1,146,294,520	1,152,991,326
TOTALI I AKTIVEVE		1,515,388,904	1,512,151,547
DETYRIMET			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime tregtare	10	175,579,616	197,403,692
Të pagueshme ndaj punonjësve	11	4,105,975	7,555,560
Të pagueshme për detyrime tatimore	12	14,793,297	3,704,519
Të tjera detyrime afatshkurtra	13	3,753,108	16,516,250
Totali I detyrimeve afatshkurtra		198,231,996	225,180,020
II. Detyrime afatgjata			
Detyrime financiare	14	801,033,107	795,979,906
Totali I detyrimeve afatgjata		801,033,107	795,979,906
Totali I Detyrimeve		999,265,104	1,021,159,927
III. Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i Nënshkruar	15	550,000,000	550,000,000
Humbje të mbartura	15	(59,008,381)	(62,965,508)
Fitim (humbja) e vitit	15	25,132,181	3,957,129
Totali I Kapitalit		516,123,800	490,991,621
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,515,388,904	1,512,151,547

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 u aprovuan nga TEGOLA EDILCENTRO Sh.p.k dhe u nënshkruan si më poshtë:



Antonio Nidoli
Perfaqesues ligjor



Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 21, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyra e Performancës & e të Ardhurave Gjithpërfshirëse

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	647,740,746	342,082,362
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimin në proces	17	3,724,043	9,620,080
Puna e kryer nga njësitë ekonomike dhe e kapitalizuar			
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	26,562,620	239,579,825
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	19	(336,554,460)	(227,159,220)
1. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme			
2. Të tjera shpenzime			
Shpenzime të personelit	20		
1. Paga dhe shpërblime		(65,550,515)	(58,622,837)
2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(10,291,736)	(8,820,248)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	21	(69,101,479)	(8,415,372)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	22	(163,517,554)	(282,112,762)
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		33,011,666	6,151,827
Të ardhura të tjera	23		
1. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
2. Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata			
3. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme		1,124,996	206,730
Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra			
Shpenzime financiare	23		
1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(1,463,587)	(2,401,429)
2. Shpenzime të tjera financiare			
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi (humbja) para tatimit		32,673,075	3,957,129
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24		
1. Shpenzimi i tatimit fitimit të periudhës		(7,540,895)	-
2. Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë			
3. Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve			
Fitimi (humbja) neto e vitit		25,132,181	3,957,129

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 21, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDREYSHË)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
-						
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2020	550,000,000	(62,965,509)	-	487,034,491		487,034,491
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitimi / Humbja e vitit			3,957,129	3,957,129		3,957,129
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Mbulim me financim nga ortakut						
Dividendë të paguar						
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike						
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2020	550,000,000	(62,965,509)	3,957,129	490,991,620		490,991,620
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2021	550,000,000	(59,008,380)	-	490,991,620		490,991,620
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitimi / Humbja e vitit			25,132,181	25,132,181		25,132,181
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Mbulim me financim nga ortakut						
Dividendë të paguar						
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike						
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2021	550,000,000	(59,008,380)	25,132,181	516,123,800		516,123,800

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 21, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
I. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit		
Fitim/ Humbja e periudhes	25,132,181	3,957,129
Rregullime per shpenzimet jomonetare:		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		
<i>Shpenzimet per tatimin mbi fitimin jomonetar</i>	-	-
<i>Shpenzime konsumi & amortizimi</i>	69,101,479	8,820,248
<i>Zhvleresimi I aktiveve afatgjata materiale</i>		
Fluksi I mjeteve monetare I perfshire ne aktivitetet investuese:		
<i>Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		(24,231,712)
Ndryshime ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit:		
<i>Renie / (rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera</i>	(11,772,174)	(36,467,665)
<i>Renie / (rritje) ne inventare</i>	1,385,765	(21,715,234)
<i>Rritje / (renie) ne detyrimet e pagueshme</i>	(21,824,075)	51,365,427
<i>Rritje / (renie) ne detyrimet per punonjesit</i>	(3,449,585)	2,556,283
<i>Rritje / (renie) ne detyrimet e tjera</i>	3,378,837	8,844,749
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	61,952,427	(6,870,775)
II. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit		
a. Para te perdorura per blerjen e filialeve (shuma neto)		
b. Para te arketuara nga shitja e filialeve (shuma neto)		
c. Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(62,404,675)	(5,777,126)
d. Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		189,684,939
e. Pagesa per blerjen e investimeve te tjera		
f. Arketime nga shitja e investimeve te tjera		
g. Dividende te arketuar		
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit	(62,404,675)	183,907,813
III. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit		
f. Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral		
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit	-	(168,499,066)
IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare	(452,248)	8,537,972
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	9,057,596	519,624
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	8,605,349	9,057,596

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 21, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Shënimet Shpjeguese

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

TEGOLA EDILCENTRO Sh.p.k (në vijim referuar si "Shoqëria") është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 30/10/2003 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria është e regjistruar në Degën e Tatimeve dhe Taksave Tiranë me NIPT/NUIS K32231003S. Shoqëria zhvillon aktivitet në fushën e Prodhimit dhe tregtimit të tullave dhe tjegullave. Kapitali aksionar fillestar i shoqërisë është 550,000,000 Lekë, i cili zotërohet si më poshtë vijon:

Ortaku: Shoqëria VECTIS SOCIETA SEMPLICE Pjesa e zotëruar 75.72 %;

Ortaku: Shoqëria EDILCENTRO Shpk Pjesa e zotëruar 24,27 %.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Z. Antonio Nidoli Adresa e shoqërisë është: Rruga Iliria, ND 18/1, Laprake Tiranë.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është 78 punonjës.

2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) në Shqipëri. Drejtimi i shoqërisë vlerëson se shoqëria do të vijojë aktivitetin normal tregtar për 12 muajt që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare. Për rrjedhojë, pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2021 janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë. Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", paragrafi 4, Shoqëria ka vendosur të mos njohë tatimet e shtyra në pasqyrat e saj financiare.

2.2 BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PARAQITJES

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 VLERËSIME DHE GJYKIME

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

Parimi i vijimësisë

Drejtimi i ka përgatitur këto pasqyra financiare në bazë të parimit të vijimësisë. Në vendosjen e këtij gjykimi, drejtimi ka konsideruar pozicionin financiar të Shoqërisë, qëllimet aktuale, përfitueshmërinë e operacioneve dhe aksesin në burimet financiare dhe aftësinë e Shoqërisë mëmë për ta mbështetur me burime financiare për në vijim.

Në Kompania planifikon flukse monetare në baza ditore, duke zbatuar kështu një politikë të menaxhimit të rregullt të likuiditetit, e cila miratohet nga menaxhmenti. Në të njëjtën kohë, ai ka përgatitur masa për parandalimin ose eliminimin e mundshëm të shkaqeve të jolikuiditetit

Parimi i krahasueshmërisë

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

3 POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të meposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare

3.1 TRANSAKSIONET NË MONEDHË TË HUAJ

Transaksionet në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhe të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit, të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është percaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i këmbimit me 31 Dhjetor 2021 leke/ euro është 123.70.

3.2 INSTRUMENTAT FINANCIAR

Instrumentat financiar jo-derivative përbëhen nga llogari të arketueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiar jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. në vijim të njohjes fillestare.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parase së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyres së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivitetit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë gjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitetit duke filluar nga dita e pare e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitetit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurter midis periudhës së qirase dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

3.4 ZHVLERËSIMI

(i) *Aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

(ii) *Aktivet jo-financiare*

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 PROVIZIONET

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parase me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 NJOHJA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat njihen në pasqyrën e performancës në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri, të ardhurat e lidhura me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- Shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do të bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% e fitimit të tatueshëm.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

3.9 KRAHASUESHMËRIA

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

4. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTËT E TYRE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Mjete monetare EUR	801,904	2,595,905
Mjete monetare ALL	7,803,446	6,461,691
Totali	8,605,350	9,057,596

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Kërkesa të arkëtueshme	130,667,797	120,707,083
Totali	130,667,797	120,707,083

6. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Tvsh ne proces gjyqesor	2,803,980	2,803,943
Akciza e rimbursueshme	5,406,010	3,594,587
Tatim fitimi ne proces gjyqesor	2,655,941	2,655,941
Totali	10,865,931	9,054,471

7. INVENTARI

Inventari më 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Mallra	218,955,306	220,341,071
Totali	218,955,306	220,341,071

8. AKTIVET AFATGJATA

Aktivët afatgjatë të shoqërisë më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Kosto	Totali	Toka	Ndertesha	Instalime	Makineri Pune	Mjete transporti	Mobilje dhe Pajisje Zyre
Me 31 Dhjetor 2019	1,789,313,894	30,000,000	173,091,578	707,297,061	806,205,032	59,949,993	12,770,231
Shtesa	5,777,126				5,476,959		300,167
Pakesime	(207,242,528)	(30,000,000)	(173,091,578)			(4,150,950)	
Me 31 Dhjetor 2020	1,587,848,492	-	-	707,297,061	811,681,991	55,799,043	13,070,398
Shtesa	62,404,673				60,908,390	101,000	1,395,283
Me 31 Dhjetor 2021	1,650,253,165	-	-	707,297,061	872,590,381	55,900,043	14,465,681
Me 31 Dhjetor 2019	(473,787,136)	-	(41,676,065)	(107,209,888)	(313,648,288)	(8,695,364)	(2,557,531)
Shtesa	(8,415,371)		(453,384)	(4,140,602)	(3,398,642)	(352,277)	(70,468)
Pakesime	46,045,342		42,129,449			3,915,893	
Me 31 Dhjetor 2020	(436,157,165)	-		(111,350,490)	(317,046,929)	(5,131,748)	(2,627,998)
Shtesa	(69,101,480)			(35,756,794)	(29,678,104)	(3,040,038)	(626,544)
Me 31 Dhjetor 2021	(505,258,645)	-		(147,107,284)	(346,725,033)	(8,171,786)	(3,254,542)
Vlera Kontabel Neto							
Me 31 Dhjetor 2019	1,315,326,857	30,000,000	131,415,513	600,087,173	492,556,744	51,254,629	10,212,700
Me 31 Dhjetor 2020	1,151,691,327	-	0	595,946,571	494,635,062	50,667,295	10,442,400
Me 31 Dhjetor 2021	1,144,994,520	-	0	560,189,777	525,865,348	47,728,257	11,211,139

9. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivët afatgjatë jomateriale të shoqërisë më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

@ net value	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Licenza për shfrytëzim të argjilës	1,000,000	1,000,000
Leje mjedisore	300,000	300,000
Totali	1,300,000	1,300,000

10. DETYRIME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	175,579,616	197,403,692
Totali	175,579,616	197,403,692

11. TË PAGUESHME NDAJ PUNONJËSVE

Detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Të pagueshme ndaj punonjësve	4,105,975	7,555,560
Totali	4,105,975	7,555,560

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 paraqiten im ë poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Detyrim për Sigurimet Shoqerore & Shendetsore	1,329,933	2,743,197
TAP	1,430,743	872,758
Detyrimi për renten minerare	88,564	88,564
Tatimi në burim	13,765	
Tatim fitimi	7,540,895	
Tvsh e pagueshme	4,389,397	
Totali	14,793,297	3,704,519

13. TË TJERA DETYRIME AFATSHKURTRA

Të tjera detyrime afatshkurtra më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Parapagime të marra	3,753,108	16,516,250
Totali	3,753,108	16,516,250

14. DETYRIME FINANCIARE AFATGJATA

Detyrime financiare afatgjata më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2019
Hua me pale të lidhura	724,842,764	741,503,557
Hua bankare	6,043,274	12,380,810
Hua nga të tjerë	65,195,982	37,100,000
Overdraft	4,951,088	4,995,540
Totali	801,033,107	795,979,906

15. KAPITALI I VET

Kapitali i vet më 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Kapitali i Nënshkruar	550,000,000	550,000,000
Humbja e mbartur	(59,008,381)	(62,965,508)
Fitimi i vitit	25,132,181	3,957,129
Totali	516,123,800	490,991,621

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

16. TË ARDHURA NGA SHËRBIMET E KRYERA

Të ardhurat nga shërbimet më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Te ardhurat nga shitja e mallrave	647,740,746	342,082,362
Totali	647,740,746	342,082,362

17. NDRYSHIMI NË INVENTARIN E PRODUKTEVE TË GATSHME DHE PRODHIMIT NË PROCES

Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces më 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	3,724,043	9,620,080
Totali	3,724,043	9,620,080

18. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Të ardhura të tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Te ardhura nga transporti	20,984,018	15,338,574
Te ardhura nga shitja e aktiveve	353,357	189,684,939
Te ardhura te tjera	5,225,245	34,556,312
Totali	26,562,620	239,579,825

19. MATERIALE TË KONSUMUARA

Materialet e konsumuara më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Materiale te konsumuara	336,554,460	227,159,220
Totali	336,554,460	227,159,220

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

20. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit më 31 dhjetor 2021 paraqiten im ë poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Pagat	65,550,515	58,622,837
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	10,291,736	8,820,248
Totali	75,842,251	67,443,085

21. SHPENZIME KONSUMI DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e amortizimit më 31 dhjetor 2021 paraqiten im ë poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Aktivët afatgjatë materiale	69,101,479	8,415,372
Totali	69,101,479	8,415,372

22. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzimet e tjera më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Materiale konsumi	52,576,085	25,788,128
Materiale elektrike	536,869	420,560
Materiale idraulike	29,840	13,583
Materiale mekanike	1,614,482	533,326
Konsulencë teknike	2,766,947	2,524,539
Shpenzime ruajtje	3,120,000	2,098,700
Lubrifikante graso	1,774,926	964,264
Mirembajtje riparime	8,082,582	3,925,814
Shpenzime pritje percjellje	546,703	390,345
Qira	22,611,469	16,669,600
Kancelari	296,825	272,135
Shpenzime ligjore, konsulenca profesionale	8,809,104	2,467,047
Shpenzime sigurimi	253,187	205,035
Shpenzime komunikimi	882,014	657,993
Shpenzime udhetime-dieta	513,223	377,269
Shpenzime transporti	20,577,535	13,829,614
Shpenzime doganore	428,661	217,336
Taksa dhe tarifa të tjera	2,563,095	2,802,063
Penalitete	(0)	83,465
Shpenzime të tjera	35,534,008	207,871,945
Totali	163,517,554	282,112,762

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

23. TË ARDHURA FINANCIARE – NETO

Të ardhurat neto financiare më 31 dhjetor 2021 paraqiten im ë poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Te ardhura financiare:		
<i>Të ardhura nga interesat</i>	-	-
<i>Të ardhura të perealizuara nga kembimet</i>	(1,124,996)	(206,730)
<i>Të ardhura të realizuara nga kembimet</i>	-	-
	(1,124,996)	(206,730)
Shpenzime financiare:		
<i>Shpenzime Interesi</i>	1,022,991	1,474,350
<i>Komisione bankare</i>	358,161	170,578
<i>Humbje të perealizuara nga kembimet</i>	82,435	756,500
<i>Humbje të realizuara nga kembimet</i>	-	-
	1,463,587	2,401,429
Totali	338,590	2,194,699

24. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Rezultati kontabël i shoqërisë është fitim në vlerën 32,673,075 lekë, ndërkohë shpenzimet e panjohura janë 26,239,962 lekë dhe rezultati fiskal është në vlerën 58,913,037 lekë. Shoqëria ka humbje fiskale nga viti 3,995,104 Leke. Tatimi mbi fitim rezulton 7,540,895 lekë ndërkohë që Shoqëria ka kryer parapagime në vlerën prej 0lekë.

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Fitimi Kontabel	32,673,075	3,957,129
Shpenzime te panjohura sipas ligjit fiskal		
Shpenzime te tjera	26,239,962	18,939,074
Gjoha dhe penalitete	-	-
Shpenzime te pritjes e perfaqesimit	-	-
Totali i shpenzimeve te panjohura	26,239,962	18,939,074
Fitimi i tatueshem	58,913,037	22,896,203
Humbje e mbartur	3,995,104	

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2021

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Tatimi mbi fitimin @ 15%	7,540,895	-
Parapagime gjate vitit 2019		-
Tatim fitimi per tu paguar	7,540,895	-

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për biznesin e madh per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021.

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

25. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë dhe masa ligjore. Vecanërisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose qe konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të periudhës raportuese, është objekt i interpretimeve të ndryshme përsa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Nën rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Me 31 dhjetor 2021, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale apo operacionale të kontraktuara por ende të papaguara.

26. NGJARJE TË MËPASSHME

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.